



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA JURIDIKE , BURIMET NJERËZORE DHE PROKURIMET PUBLIKE

Nr. 1572/2 Prot

Maliq, më 10.03.2023

Lënda: Kërkesë për shpallje

Drejtuar: Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Mardhënieve me Publikun

Këtu

Njesisë Administrative Libonik

Në mbështetje të Kreut II, pika 3 të Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, bashkangjitur ju dërgojmë shkresën “Njoftim Publik” me Nr. 1572/2 Prot, datë 10.3.2023, për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandarë me Nr. 1112 dhe 1113 Pasurie, Zonë Kadastrale 3897, fshati Zboq, Njësia Administrative Libonik, në mënyrë që të bëni të mundur shpalljen e saj në ambientet publike, gjithashtu dhe në faqen zyrtare të webit të Bashkisë Maliq nga ana e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Ju faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 1572/11 Prot

Maliq më, 10.03.2023

NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma a, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1111, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Libonik të Qarkut të Korçës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 “Për Tokat Bujqësore të Pandara”, Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Kreu I pika 5, Kreu II pika 1 dhe 3, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 42, datë 29.04.2022 “Për rishqyrtimin e Vendimit Nr. 28, datë 25.02.2022 “Për miratimin e listës së tokave të pandara bujqësore në fshatin Zboq, Njësia Administrative Libonik, me qëllim dhënien me qira të tyre”,

Bashkia Maliq, njofton se jep me qira tokat bujqësore të pandara me ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, në fshatin Zboq, Njësia Administrative Libonik, si më poshtë:

- Pasuria Nr. 1112, Zonë Kadastrale 3897, e llojit “arë”, me sipërfaqe 3400 m²
- Pasuria Nr. 1113, Zonë Kadastrale 3897, e llojit “arë”, me sipërfaqe 6400 m²

Të interesuarit të paraqesin kërkesat e tyre pranë Bashkisë Maliq, brenda datës **20.03.2023**.

Ankandi për dhënien e tokës me qira do të zhvillohet në datën **23.03.2023**, ora **10:00**, pranë Bashkisë Maliq.

KRYETAR I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

